



A2020021870053219861

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI (TË SHOQËRISË "ANSI 2016" SH.P.K)

Sot, më datë 21.08.2020, para meje Noter EDVIN G. KOLAGJI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore GJIROKASTËR , me zyrë në adresën Sarandë, NR.1, ONHEZMI, NR.17, PERBALLE GJYKATES, u paraqit personalisht:

SHITES:

Ortaku i vetem i Shoqërise ANSI 2016, regjistruar si shpk në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L84702803P, me seli në adresë Lagjia 1, Rruga Skenderbeu, Godina Nr 1, kati i pare., Arbër Hoxha, atësia Guxim, amësia Anife, shtetas Shqiptar, lindur në Delvine(ALB) dhe banues në Delvinë, me adresë Lagjia 9 Tetori; , lindur më 01/04/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BD3389605 dhe nr. personal I50401082K.

BLERES:

Gentjan Zeneli, atësia Yzeir, amësia Shaneko, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore(ALB) dhe banues në SARANDË, lindur më 08/01/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BD1166477 dhe nr. personal I00108080J.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "ANSI 2016" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

TE DHENAT PARAPRAKE

Sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit date 21.08.2020, është regjistruar subjekti ANSI 2016 me numer unik identifikimi (NUIS) L84702803P, forma ligjore Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e cila e ushtron aktivitetin me seli në Sarandë Lagjia nr.1 RRUGA Skenderbeu, godina nr.1, kati i pare. Kjo shoqëri është e përbërë nga ortaku i vetem Z.Arber Hoxha i cili zotëron të gjithë numrin e pjesëve 1,00 në vlerë kapitali 100.000 leke.

Me vendim Nr.4 date 19.08.2020 të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ANSI 2016 SHPK asamblëja e ortakeve të shoqërisë ka vendosur shitjen e 100% të kuotave në numrin e pjesëve 1,00 në vlerë kapitali 100.000 leke tek ortaku i ri i shoqërisë Z.Gentjan Zeneli, si dhe ndryshimin e administratorit të shoqërisë nga Arber Hoxha në administratorin e ri Gentjan Zeneli.

OBJEKTI

Shitjen e 100% të kuotave në numrin e pjesëve 1,00 në vlerë kapitali 100.000 leke të zotëruara nga ortaku dhe administratori i vetem Z. Arber Hoxha tek ortaku i ri i vetem dhe administratori i vetem i ri Z.Gentjan Zeneli.

Sipas dokumentit të leshuar nga Kryeregjistruesi i Barreve Siguruese, mbi këtë pasuri(kuota) nuk rezulton të jetë vënë barre siguruese.

CMIMI I SHITJES

Palët e kësaj kontrate kanë rënë dakort që cmimi i shitjes së 100% të kuotave në numrin e pjesëve



1,00 nga kapitali fillestar, te jete ne vleren prej 100.000(njeqind mije)leke. Likujdimi i vleres se kesaj shitje, sipas deklarimit te paleve eshte bere ne marreveshje jashte kesaj zyre noteriale dhe palet e kesaj kontrate nuk kane me pretendim per cmimin dhe menyre e likujdimi te kesaj shume.

KALIMI I KUOTAVE

Me perpilimin e kesaj kontrate per shitblerje kuotash(kapitali) te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ANSI 2016, ortakut i vetem Arber Hoxha e humbet kete cilesi dhe ortak i vetem i shoqerise behet bleresi i kuotave Gentjan Zeneli, i cili do kete ne zoterim 100% te pjeseve te kuotave te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

DETYRIMET E PALEVE

Pala shitese garanton palen blerese se kuotat e zoteruara prej saj jane te lira dhe mbi ato nuk rendon barre siguruese.

Pala blerese duhet te regjistroje kalimin e kuotës ne baze te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Me regjistrimin e kuotave nga pala blerese do te behet dhe ndryshimet e ortakut si dhe ndryshimin e administratorit te shoqerise

LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande.

INTERPRETIMI I KONTRATES

Kontrata duhet te interpretohet ne mirebesim nga palet.

Kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kete ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.

Dokumentet qe i bashkengjiten kesaj Kontrate Shitblerje si pjese integrale te saj jane:

- 1-Ekstrakt Historik e Regjistrimit Tregtar.
- 2-Vendimi i asamblese se ortakëve te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ANSI 2016.
- 3-Dokument konfirmimi nga Regjistri i Barreve Siguruese.
- 4-Dokumentet e identitetit te paleve shitesi – blerësi.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

pulla e takses u aplikua.

SHITES

Arbër Hoxha

Arber Hoxha

BLERES

ortaku i ri dhe administrator i ri i Shoqërisë ANSI 2016

Gentjan Zeneli

Gentjan Zeneli



NOTER
EDVIN G. KOLAGJI

[Signature]